



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
DREJTORIA E FINANCËS

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2015

**Drejtuar: MINISTRISË SË FINANCAVE  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT**

**TIRANË**

**Lënda:** Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetor për vitin 2014.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit Nr. 3, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, po paraqesim informacion mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për vitin 2014, për sistemin e MZHETS-së.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e MZHETS-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara për vitin 2014.

Fondet buxhetore të planifikuara, për vitin 2014, për sistemin e MZHETS-së, janë 1,659,700 mijë lekë. Këto fonde menaxhohen në 3 programe që përfshijnë 9 institucione buxhetore, të cilat sipas strukturës buxhetore paraqiten:

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani 2014	Buxheti rishikuar për vitin 2014	Realizimi faktik për vitin 2014	Realizimi për vitin 2014 në %
Paga dhe Sigurimet	435,000	395,500	372,525	94 %
Shpenzime të tjera korrente	273,200	451,611	398,746	88 %
Investime të brendshme	181,500	168,853	150,526	89 %
Financime të huaja	770,000	517,000	420,830	81 %
<b>TOTALI</b>	<b>1,659,700</b>	<b>1,532,964</b>	<b>1,342,627</b>	<b>88 %</b>

Referuar kësaj tabele, realizimi i treguesve buxhetor për vitin 2014, është 88 %. Më poshtë analizojmë faktorët që kanë ndikuar:

- ❖ **Shpenzimet e Personelit**, janë realizuar 94 %, për arsye të mosplotësimit të vendeve vakante në strukturat e institucioneve, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri të statusit të nëpunësit civil dhe si arsye e disa raporteve të zgjatura pagesat e të cilave kryhen nga Sigurimet Shoqërore.
- ❖ **Shpenzimet e tjera korrente**, janë realizuar në masën 88 % si rezultat:
  - *Aparati MZHETS*, kishte planifikuar për të likuiduar detyrimet e prapambetura të vendimeve gjyqësore nga shpenzimet operative , ndërkohë me shkresën Nr.16829/1, datë 04.12.2014 Ministrisa e Financave, akordon fondin me vlerën 28,190 mijë lekë, për këtë qëllim.
  - *Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve*, në lidhje me mosrealizimin e plotë të fondit për shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes, argumenton se ishte planifikuar organizimi i disa eventeve në kuadër të SME Week nëpër 12 qarqe, po si pasojë e kohës së shkurtër në dispozicion ato u reduktuan vetëm në tre qytete. Gjithashtu ishin planifikuar dhe disa udhetime në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në EXPO Milano të cilat nuk u realizuan. Në disa raste si pasojë e procedurave të prokurimit fondet e planifikuara rezultuan në vlerën më të lartë se vlera e prokuruar.
  - *Qendra Kombëtare e Regjistrimit*, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes ishin programuar në vlerën prej 62,000 mijë lekë, dhe janë realizuar në vlerën 43,321 mijë lekë, ose 70 %. Ky realizim argumentohet nga diferenca e mbetur e fondeve limite të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga QKR dhe vlerave të kontratave të lidhura me operatorët fitues. Që do të thotë se fondi limit i prokuruar është më i madh se vlera e kontratës së shpallur fituese për të njëjtën procedurë.  
Për vitin 2014 transfertat për Njësitë Vendore ishin parashikuar në vlerën 55,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 48,187 mijë lekë ose 88%. Kjo për arsye të mosplotësimit të vendeve vakante në disa sporteleve. Mosrealizimi argumentohet gjithashtu për shkak se njësitë e qeverisjes vendore pranë së cilës është i vendosur sporteli i QKR-së, nuk kanë realizuar fondin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes duke mos mbështetur punën e sportelistëve me bazën e nevojshme materiale.
  - *Qendra Kombëtare e Licencimit*, në lidhje me shpenzimet operative ishte parashikuar në vlerën 11.500 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 9,214 mijë lekë, ose 80 %. Ku pjesën kryesore në parashikim e zinte “Mirëmbajtja dhe përditësimi i sistemit elektronik” në masën 6.000 mijë lekë. Meqenëse procedurat e kontraktimit, duke përfshirë kohën e miratimit të projektit nga AKSHI, si dhe procedurat e prokurimit kërkuan më shumë kohë nga çfarë ishte parashikuar, shpenzimet e mirëmbajtjes dhe përditësimit të sistemit u realizuan në masën 4.178 mijë lekë. Kjo ndikoi në mosrealizimin e plotë të shpenzimeve operative.
  - *Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve* për sa i përket shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, janë realizuar vetëm dy procedura prokurimi me “Blerje me vlerë të vogël”. Mos arritja e objektivave të parashikuara nga ATRAKO për numërin e projekteve koncesionare, është për shkak të problematikave që ka hasur pas hyrjes në fuqi të Ligjit 125/2013 "Për Koncesionet dhe PPP", si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;
  - *Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit*, për arsye të humbjes së dokumentave të urdhër shpenzimeve në Degen e Thesarit Tirane, për likuidimin e energjisë elektrike e cila ka një vlerë prej 198 mijë lekë, për likuidimin e ujit, e cila ka një vlerë prej 50 mijë lekë, si dhe moslikuidimin në kohë të shpenzimeve të bordit, pasi nuk erdhën proces-verbalet e mbledhjeve.

❖ **Duke analizuar realizimin e Investimeve të brendshme, rezulton se shpenzimet për investime janë realizuar në masën 89%. Po permendim disa arsye kryesore:**

- *Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve*, në dallim nga vitet e tjera arriti të realizojë projektet e investimeve 89% krahasuar me vitet e mëparshme, realizimi me i mire ka rezultuar në vitin 2013.  
Kjo Agjenci ka punuar për vitin 2014 duke i promovuar këto fonde dhe ndërgjegjësuar biznesin, për mënyrën e aplikimit të tyre dhe përfitueshmerine për përmirësimin e klimës së biznesit, në ndihmë të bizneseve eksportuese, të bizneseve inovatore të teknologjisë si dhe bizneseve fillestare në treg. Kështu për Fondin e Konkureshmërisë, janë miratuar aplikimet, por disa subjekte që morën miratimin e Komisionit të Aprovimit të Grantit, nuk mundën të mbyllnin në kohë procedurat për projektin e propozuar.  
Ndërsa për Projektin “Expo Milano 2015”, VKM Nr. 813, ka hyrë në fuqi në datë 11.12.2014, informojmë se ky fond nuk mund të përdorej nga AIDA, pasi koha për të kryer procedurën e prokurimit si dhe realizimin e shërbimit të kërkuar ishte e pamjaftueshme.
- *Drejtoria e Përgjithëshme e Metrologjisë*, në lidhje me projektin “Kompletimi i laboratorit të volumeve të mëdha”, është realizuar në masën 87%, për arsye se kontraktuesi i projektit realizoi pjesërisht marrëveshjen, për efekt të moslevrimit të mallit në kohë, solli mosrealizimin e vlerës së parashikuar sipas kontratës së nënshkruar.
- Një arsye tjetër që ka ndikuar në masën e realizimit në vlerë, të fondeve të planifikuara për investime publike sipas projekteve, janë diferencat nga procesi prokurimeve, ndërmjet fondeve të planifikuara dhe atyre të kontraktuara.

❖ **Lidhur me Financimin e Huaj, janë realizuar në masën 81 %, për arsye se:**

- *Projekti “Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri nëpërmjet një linje kredie për SME-të dhe sigurimin e Asistencës Teknike për to”* nga 510,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 414,260 mijë lekë ose 81 % për vitin 2014.  
Për natyrën e veçantë që ka Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve dhe skemës ligjore sipas të cilës funksionon, realizimi faktik i fondeve, apo financimi i Projekteve të SME-ve, quajtur ndryshe në terminologjinë e Programit, është krejtësisht jashtë vendimmarrjes së Programit. Kjo për faktin se, në bazë të Marrëveshjeve ligjore midis Qeverisë Shqiptare dhe Italiane, Programi është krejtësisht i përjashtuar nga vendimmarrja në financimin e Projekteve të SME-ve.  
Në bazë të Marrëveshjes Qeveritare, Programi i Kooperacionit Italian, nënshkruan Marrëveshje Huadhënie me Bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Kërkesat e subjekteve për financimin e projekteve nuk paraqiten në PMU, por në Bankë.  
Pavaresisht nga kjo, Programi Italian për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri është një ndër programet më të suksesshme të viteve të fundit në Shqipëri, i aftë të ndihmojë konkretisht dhe shpejt me likuiditet sipërmarrjet shqiptare, sidomos në këtë periudhë shumë të vështirë dhe delikate që po kalon jo vetëm ekonomia jonë, por mbarë ekonomia evropiane. Realizimi faktik i fondeve për vitin 2014 është rritur me 2.71 herë, krahasuar me vitin 2013.
- *Projekti “Mbrojtja e markave për produktet ndërkufitare”* nga 6,630 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 6,570 mijë lekë ose 99 % për vitin 2014, sepse nuk janë konfirmuar përgjigjet për disa oferta të nisura për materiale promocionale, theksojmë se vlera e disbursuar për projektin është në masën 100% e fondit.

## Të analizuara sipas programeve treguesit buxhetor paraqiten si më poshtë:

### 1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”.

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani për vitin 2014	Fakti për vitin 2014	Realizimi për vitin 2014 në %
Pagat	101,000	99,001	98 %
Sigurimet shoqërore	20,000	17,192	86 %
Shpenzimet operative	184,255	167,119	91 %
Trasferta me jashtë	16,700	16,620	100 %
Trasferta tek individ	13,958	12,681	91 %
<b>Totali Shpenzime korrente</b>	<b>335,913</b>	<b>312,613</b>	<b>89 %</b>
Investime të brendshme	35,875	34,832	97 %
Financim i huaj		0	0
<b>Totali Financime buxhetore</b>	<b>371,788</b>	<b>347,445</b>	<b>93 %</b>

**Pagat dhe sigurimet shoqërore**, nga 121,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 116,193 mijë lekë ose 96 %. Në këtë masë realizimi, kanë ndikuar mosplotesimet e vendeve vakante dhe ndryshimet në strukturë.

**Shpenzimet operative**, nga 184,255 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 167,119 mijë lekë ose 91 %. Kemi një rritje të planit për shpenzimet operative për Aparatin e MZHETS-së, si pasojë e akordimit nga Ministria e Financave të një fondi të veçantë në zbatim të Vendimit Nr.7, datë 22.05.2014 për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, me vlerën 89,927 mijë lekë për likuidimin e vendimeve gjyqësore, si dhe shtesë tjetër në datën 04.12.2014 me vlerën 28,190 mijë lekë. Nga MZHETS u kërkua Ministrise së Financave për të tërhequr fondin e rialokuar nga kjo Ministri por i papërdorur nga ana jonë, por kjo gjë nuk u realizua.

**Trasferta me jashtë**, janë realizuar 100 %, mbi bazën e faturave të paraqitura nga organizmat ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është e anëtarësuar.

**Trasferta tek individ**, nga 13,958 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 12,681 mijë lekë ose 91 %, si pasojë e përfundimit të pagesës së punonjësve në listë pritje, për arsye të ristrukturimit.

**Investime kapitale të brendshme**, nga 35,875 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 34,832 mijë lekë ose 97 %. Theksojmë se këto diferenca janë ndërmjet fondit limit të planifikuar dhe atij të kontraktuar, por si projekte të planifikuara, ato janë realizuar 100%.

Në përputhje me Programin e Qeverisë për forcimin e kapaciteteve në Administratën Publike, si një produkt të rëndësishëm të këtij programi përmendim trainimin e stafit të Aparatit të Ministrisë dhe institucioneve të sistemit të MZHETS-së mbi bazën e një Programi Pune të mirëpërcaktuar. Në këtë kuadër për stafin e Ministrisë (110 punonjës) janë bërë disa trainime në ambientet e Ministrisë, lidhur me tema si Çështje të Integritit European, Ligji i ri për Statusin e Nëpunësit Civil, Rregullat e Etikës në Administratën Publike, Konflikti i Interesit si dhe tema specifike që kanë të bëjnë me rritjen e konkurrueshmërisë të SME dhe monitorimin e investimeve publike. Gjithashtu trainime janë bërë edhe nga ASPA, për tema specifike sipas nevojave të punonjësve.

## 2. Programi “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik”.

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani për vitin 2014	Fakti për vitin 2014	Realizimi për vitin 2014 në %
Pagat	102,500	90,864	89 %
Sigurimet shoqërore	15,500	14,637	94 %
Shpenzimet operative	96,900	70,408	73 %
Trasferta të brendshme	55,000	48,187	88 %
Trasferta me jashtë	0	0	0
Trasferta tek individ	64	64	100 %
<b>Totali Shpenzime korrente</b>	<b>269,964</b>	<b>224,160</b>	<b>83 %</b>
Investime të brendshme	101,228	87,501	86 %
Financim i huaj	510,000	414,260	81 %
<b>Totali Financime buxhetore</b>	<b>881,192</b>	<b>725,921</b>	<b>83 %</b>

**Pagat dhe sigurimet shoqërore**, nga 118,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 105,501 mijë lekë ose 90 %. Siç e përmendëm edhe më sipër në këtë masë realizimi, kanë ndikuar mosplotesimi i vendeve vakante dhe raportet e zgjata që paguhen nga sigurimet shoqërore.

**Shpenzimet operative**, nga 96,900 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 70,408 mijë lekë ose 73 %. Në këtë zë kanë ndikuar faktorët e sipërpërmendur, për këto institucione (AIDA, QKR, QKL dhe ATRAKO), të cilat janë pjesë e këtij programi.

**Trasferta të brendshme**, nga 55,000 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 48,187 mijë lekë ose 88 %, si rezultat i transferimit të 3 sporteleve të QKR-së.

**Investime kapitale të brendshme**, nga 101,228 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 87,501 mijë lekë ose 89 %.

Në këtë program, Agjencina Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka peshën më të madhe të vlerës së Investimeve Publike. Ndërkohë theksojmë se është bërë siç e përmendëm edhe më sipër një punë e vazhdueshme për promovimin e fondeve të miratuara, për këtë Agjenci dhe për ndërgjegjësimin e biznesit për mënyrën e aplikimit të këtyre fondeve.

Ndërsa Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ka aplikuar një mënyre tjetër për realizimin e Projektit “Blerja e sitemit të numerimit për sportelet e QKR-së” duke proceduar me leter kredie të miratuar nga Ministria e Financave e cila nuk u realizua.

## 3. Programi “Mbështetje për Mbikqyrjen Tregut, Infrastukturën e Cilësive e Pronësi industriale”.

në 000/lekë

Struktura buxhetore	Plani për vitin 2014	Fakti për vitin 2014	Realizimi për vitin 2014 në %
Pagat	133,600	129,458	97 %
Sigurimet shoqërore	22,900	21,373	93 %
Shpenzimet operative	66,744	65,861	99 %
Trasferta të brendshme	0	0	0
Trasferta me jashtë	17,375	17,284	99 %
Trasferta tek individ	615	521	85 %
<b>Totali Shpenzime korrente</b>	<b>241,234</b>	<b>234,497</b>	<b>97%</b>
Investime të brendshme	31,750	28,194	89 %
Financim i huaj	7,000	6,570	94 %
<b>Totali Financime buxhetore</b>	<b>279,984</b>	<b>269,261</b>	<b>96 %</b>

**Pagat dhe sigurimet shoqërore**, nga 156,500 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 150,830 mijë lekë ose 96 %.

**Shpenzimet operative**, nga 66,744 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 65,861 mijë lekë ose 99 %.

**Trasferta me jashtë**, nga 17,375 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 17,284 mijë lekë ose 99 %, mbi bazën e faturave të paraqitura nga organizmat ndërkombëtare në të cilat, janë të anëtarësuar institucionet e përfshira në këtë program.

**Trasferta tek individ**, nga 615 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 521 mijë lekë ose 85%. Transferimi i fondit në këtë llogari ishte i domosdoshëm për realizimin e pagesave të punonjësve të larguar nga puna për arsye ristrukturimi, të Drejtorisë së Përgjithëshme të Akreditimit, si dhe mosralizimi në masën 100%, erdhi si rezultat i planifikimit të likuidimit në fund të vitit ndërsa pagesa duhet të kryej në fillim të janarit 2015, në mbështetje të akteve ligjore.

**Investime kapitale të brendshme.** nga 31,750 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 28,194 mijë lekë ose 89 %.

**Financim i huaj**, *Projekti “Mbrojtja e markave për produktet ndërkufitare”*, nga 7,000 mijë lekë të planifikuara, është realizuar 6,570 mijë lekë ose 94%, sepse nuk janë konfirmuar përgjigjet për disa oferta të nisura për materiale promocionale.

Theksojmë se vlera e disbursuar për projektin është në masën 100% e fondit të planifikuar.

Në përfundim vlen të theksohet, likuidimi i detyrimeve të prapambetura, gjë e cila lehtësoi nga borxhet sistemin e MZHETS-së, mbështetur në Vendimit Nr. 50, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, Udhezimit Nr.5, datë 27.02.2014 të Ministrisë së Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura“, Vendimit Nr.7, datë 22.05.2014 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura (KDP), si dhe shkresës të Ministrisë së Financave me të cilën akordon fondin me vlerën 144,051 mijë lekë, për këtë qëllim.

Gjithashtu përqëndrimi i Fondit të Veçantë me vlerën 710 mijë lekë, ka bërë që të kemi një përdorim sa më efektiv të tij, për sistemin e MZHETS-së.

Duke falenderuar për bashkëpunimin.

**FREDERIK SEITI**

.....

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**